

Diskutim për politika publike nr. 25/2020

-

Roli i Kuvendit në integrimet europiane: antikorrupsioni

Autor: Misha Popoviq

-

qershor 2020

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument jo domosdoshmërisht i shprehin pikëpamjet e Fondacionit Nacional për Demokraci nga SHBA-ja dhe Institutit për demokraci "Societas Civilis"- Shkup

Impressum

—

Titull: Roli i Kuvendit në integrimet europiane: antikorrupsioni

Botues: Institutit për Demokraci
"Societas Civilis" - Shkup

Authorë: Misha Popoviq

Përkthim: Litra

Dizajni: Dejan Kuzmanovski

Ky publikim është i disponueshëm në:

<https://idscs.org.mk/mk/portfolio/roli-i-kuvendit-ne-integrimet-europiane-antikorrupsioni/>

Në fillim të shkurtit të vitit 2020, Komisioni European prezantoi metodologjinë e re negociuese. Risia kryesore është grupimi i kapitujve sipas të cilëve vendet e mëparshme kandidate kanë negociuar, në të ashtuquajturit "klasterë". Arsyeja për një gjë të tillë është lidhja ndërmjet kapitujve dhe nevoja që reformat të përcaktohen nëpër më shumë sektorë së bashku. Klasteri me më shumë sfida është gjithsesi i pari, i titulluar si „Baza“ në të cilin hyn, ndërmjet të tjerash edhe sundimi i së drejtës dhe lufta kundër korrupsionit.

Në Maqedoninë e Veriut kur flasim për këto dy tema, flasim për një problem të pakapërcyeshëm. Si të kemi sukses në luftën kundër korrupsionit, kur kemi problem me sundimin e së drejtës. Si t'i dënojmë të korruptuarit, nëse nuk kemi një gjyqësor të pavarur. Si të presim që drejtësia t'i arrijë të korruptuarit nëse ata mund të blejnë lirinë e tyre, ose, akoma më keq, e mjaftueshme është që t'i njohin personat e vërtetë.

Problemet me këto dy fusha theksojnë rëndësinë e Kuvendit. Ai qëndron përkundër dy pushteteve me kompetenca ekzekutive – pushtetit ekzekutiv me ministritë dhe agjencitë, dhe gjyqësorin në procesin e afrimit drejt BE-së. Në mënyrë plotësuese, para tij përgjigjen edhe institucionet e specializuara të cilat i ka formuar vetë, siç janë komisionet për parandalimin e korrupsionit dhe mbrojtjes së konkurrencës, dhe një varg trupash të tjera rregulluese.

Që këtu, Kuvendi mund të ketë rolin kryesor në sjelljen e aktvendimeve të dukshme për qytetarët. Dhe pikërisht rezultatet e dukshme për qytetarët janë përmendur shprehimisht si kusht për afrimin drejt BE-së. Kjo vjen si nevojë për të shmangur përsëritjen e mosbesimit ndaj procesit integruar që u shfaq në disa vende të Europës Lindore, ku hyrja në BE nuk nënkuptonte përfitime në jetën e përditshme të shumë qytetarëve.

Për të pasur zgjidhje të dukshme reformat

duhet të kenë një qëllim të qartë zhvillues. Qëllimi i reformave nuk mund të jenë vetë reformat, por ato duhet të sigurojnë kushte që institucionet të ofrojnë shërbime cilësore për qytetarët. Kjo, në radhë të parë duhet të ndihmojë sundimin e së drejtës, dhe të jetë forum aktiv i një vullneti politik të fortë nga pushteti dhe opozita për reforma të qëndrueshme. Kuvendi është vendi kryesor për organizimin e dialogut ndërmjet pushtetit, opozitës, dhe shoqërisë civile rreth qëllimeve afatgjata të reformave që do të bëhen në procesin e afrimit. Fokusi drejt rezultateve të prekshme është përmendur qartë në metodologjinë e re. Kurse Komisioni Europian theksoi në mënyrë plotësuese se i shikon parlamentet kombëtare të vendeve të Ballkanit Perëndimor si lidhje ndërmjet qytetarëve dhe Brukselit.

Sa strategji janë të nevojshme për të zëvendësuar llambën dhe për të ndriçuar gjykatësit dhe prokurorët publikë të korruptuar?

—

Nëse integrimin tonë europian e shikojmë si një maratonë, bilbili që shënon fillimin e garës duhet të nënkuptojë se kemi një nivel të pranueshëm të sundimit të së drejtës. Asnjë reformë nuk ka kuptim, nëse aktorët e korruptuar e dinë se edhe të kapur do të mund të ndikojnë dhe t'i shmangen drejtësisë. Përkundrazi, ata do të lejojnë që të kalojë koha në përpilimin e ligjeve dhe strategjive më të reja, që më tej nuk do të zbatohen. Madje edhe po të zbatohen, ajo që është më e rëndësishmja – aktgjykimi – është diçka që aktorët e korruptuar do ta kenë nën kontroll.

Prandaj, sundimi i së drejtës nuk mund të dalë nga strategjia, por nga një trysni e organizuar. Rolin kryesor këtu e kanë mediumet dhe shoqëria civile të cilat duhet të identifikojnë në mënyrë të saktë aktorët

e korruptuar në gjyqësor, me emër dhe mbiemër. Në këtë mënyrë, korrupsioni merr formë dhe veprim, përkatësisht janë identifikuar gjykatësit dhe prokurorët e korruptuar, ndërsa kur do të dalin në pah veprat, nuk flasim më vetëm për përshtypje të përgjithshme.

Në atë moment, është hapur një hapësirë për trysni ndaj vetë- rregullimit, ku Kuvendi mund të luajë rolin kryesor.

Si Këshilli Gjyqësor ashtu edhe ai i Prokurorëve Publikë deri tani kishin një pozicion të rehatshëm ku mbikëqyrjen nga ana e gazetarëve dhe shoqërisë civile e përjetonin „në terrenin e tyre” – në konferencat e shtypit të tyre, ose emisione debatuuese. Kuvendi nuk arriti të imponojë trysni në rritje ndaj këtyre këshillave të cilët duhet t’u shpjegojnë në vazhdimësi pyetjeve të deputetëve se si veprojnë gjatë rasteve kontraverze, për cilësinë e dobët të aktgjykimeve dhe lejimin e vjetërsimit të çështjeve kryesore.

Që këtu, thelbësore është që përbërja e ardhshme e Parlamentit të marrë pjesë në mënyrë të përforcuar në trysninë kolektive mbi pushtetin gjyqësor. Kuvendi gjithsesi ka mandat të demonstrojë pakënaqësinë politike ndaj gjyqësorit

dhe të insistojë për profesionalizim dhe vetë-rregullim. Në këtë mënyrë, Kuvendi mund të kontribuojë në mënyrë serioze në sigurimin e bazës për reforma të gjera – sundimin e së drejtës.

Vullneti politik si proces kolektiv

Kuptohet, është naive të pritët që të gjithë 120 deputetët të jenë të vendosur për të luftuar kundër korrupsionit dhe në dobi të sundimit të së drejtës. Një nga gjërat më të famshme rreth luftës së suksesshme kundër korrupsionit është e ashtuquajtura „ekzistenca e vullnetit politik”. Pothuajse të gjitha analizat e temës, përfshirë këtu edhe autorin, e përmendin në mënyrë të pashmangshme. Megjithatë, jo rrallë, ai vullnet politik mbetet i pashpjeguar. Shpeshherë, vullnetin politik e mendojmë nëpërmjet prizmit të leksioneve historike për shtete që kanë arritur të jenë shembull i të qenit të pakorruptuar. Këto leksione shpesh përmbajnë një monark absolut të edukuar, i cili ka vendosur që rruga e vërtetë është menaxhimi i mirë. Meqenëse ka qenë në pozitën

e një pushteti (pothuajse) absolut, kundërshtarët e menaxhimit të mirë nuk mund të jenë pengesë e rëndësishme ose afatgjatë e proceseve të tilla.

Ashtu si ai, komentuesit shpesh presin udhëheqësit reformatorë të sotëm të kenë të njëjtin rol. Megjithatë, në vitin 2020, madje edhe në demokraci disfunksionale flasim për të paktën ndarje formale të pushtetit. Një ndarje e tillë nuk mundëson ndërhyrje direkte të politikanëve reformatorë ashtu siç bënin monarkët absolutë në të kaluarën. Nga ana tjetër, kjo është në interes të strukturave të korruptuara, në cilëndo degë të pushtetit, të mos lejojnë përzierjen e reformistëve duke i akuzuar për tejkalimin e kompetencave të tyre. Lejimi i precedentëve të përzierjes së pushteteve të njëri-tjetri, është gjithmonë thikë me dy tehe. Nëse lejohet tejkalimi që të çrrënjoset struktura e korruptuar, pastaj si bumerang mundëson strukturën e korruptuar ta eliminojë të njëjtën. Prandaj, vullneti politik nuk mund të bartet nga udhëheqës karizmatikë sepse, edhe nëse është i sigurtë, ai nuk është i qëndrueshëm. Një vullnet politik i vendosur në këtë mënyrë është kapaciteti i vetëm për ndryshime, dhe nëse liderët

zhduken nga skena edhe zhduken edhe bazat për luftën kundër korrupsionit. Vullneti politik duhet të definohet në mënyrë kolektive, si konsensus në kornizat e grupeve të aktorëve politikë, dhe më tej konsensus i më shumë grupeve të aktorëve politikë që kanë ndonjë fuqi vendimtare.

Nëse një qeveri, ose koalicion nuk ka arritur konsensus për luftë kundër korrupsionit, atëherë nuk mund të flasim për ekzistimin e vullnetit politik, sepse iniciativat individuale të politikanëve reformatorë janë të cenueshme jashtë sektorëve të cilat i menaxhojnë. E njëjta mund të thuhet edhe për Kuvendin ku konsensusi nënkupton pëlqimin ndërmjet deputetëve me ndikim pa dallim nëse janë në pozitë apo opozitë. Në të kundërt, procesi i vendimmarrjes është viktimitë e korrupsionit.

Kuvendi është forumi ku grupet e ndryshme politike mund të demonstrojnë angazhimin e tyre për sundimin e së drejtës dhe luftën kundër korrupsionit. Ky angazhim mund të nënkuptojë vetëm përkrahjen e pavarësisë së institucioneve, që luftojnë kundër korrupsionit dhe sigurojnë sundimin e së drejtës.

Sigurimi i integritetit institucional në vend të atij individual

Që këtu, nëpër rrugën e integritetit evropian, roli i Kuvendit është që të jetë skeptik ndaj suksesit të institucioneve të cilat bazohen në individë. Suksese të tilla janë kalimtare, dhe shpesh e nënvleftësojnë nevojën e investimit në kapacitetet e institucioneve të bazuara në rregulla të përcaktuara të cilat parandalojnë keqpërdorimet.

Qëllimi është, në fundin e procesit, institucionet kryesore të jenë rezistues ndaj regresit në sundimin e së drejtës, pa dallim nga klima politika dhe vullneti, por edhe i përpjekjeve për infiltrimin e brendshëm të strukturave të korruptuara.

Roli i Kuvendit këtu është i rëndësishëm. Reforma të tilla të brendshme kërkojnë investime ndërsa Buxhetin e miratojnë deputetët. Ndërtimi i integritetit institucional së pari kërkon diagnozë për të përcaktuar dobësitë, dhe pastaj

investim në kapitalin njerëzor, ndërsa për shumë sektorë do të kërkojë rritjen e kapaciteteve, mungesa e të cilave është burim i korrupsionit (për shembull shtretërit e spitaleve në shëndetësi).

Bashkimi strategjik i reformave në qëllim zhvillues

Ajo që u përmend deri më tani duhet të përfaqësojë themelin për të bërë të mundur plotësimin e lidhjes strategjike të reformave të posaçme institucionale në përmirësimin ndër sektorial. Parimi i grupimit në kapituj për negociata padyshim imponon perspektivë më të gjerë të sukseseve në sektorë individual.

Shkaku për këtë është se ndryshimet për qytetarët janë të dukshme në këtë nivel. Për ta e dukshme është kur proceset do të sjellin rezultate si për shembull shërbim më të mirë shëndetësor. Ndërsa për

shërbim më të mirë shëndetësor, është e nevojshme të zvogëlohet korrupsioni në shumë sektorë. Së pari, përmirësimi i arsimit të lartë i cili do të profilizojë kuadro sipas dijeve dhe jo nepotizmit ose shërbimeve partiake. Pastaj institucionet shëndetësore të punësojnë mbi bazën e kompetencave, ndërsa gjatë prokurave publike të çrrënjoset ndikimi jolegal i industrisë farmaceutike. Në të njëjtën kohë, gjatë krijimit të politikave shëndetësore të mënjanohet interesi i spitaleve private gjatë krijimit të politikave shëndetësore dhe paratë e kursyera nga zvogëlimi i korrupsionit të investohen në kapitalin njerëzor.

Pikërisht nevoja e sigurimit të „pamjes së madhe“ ofron mundësi drejt reformave të bashkëngjiten qëllime zhvilluese, dhe jo reforma në vetvete. Lufta kundër korrupsionit dhe angazhimi për sundimin e së drejtës duhet të jenë mjet me të cilin do të përmirësohen arsimi dhe shëndetësia, do të zvogëlohet ndotja, do të përmirësohet ekonomia dhe punësimi.

Megjithatë për këtë është i nevojshëm dialog shoqëror, sepse ndryshime të tilla i tejkalojnë ciklet politike prej katër vitesh. Për dimensionin zhvillues të reformave është i nevojshëm konsensusi ndërmjet partive politike, por edhe aktorët e tjerë në sektorin civil dhe të biznesit.

Kuvendi si dhoma e përfaqësuesve është forumi ideal për një dialog të tillë. Përveç rolit të tij si krijues i politikave, me këtë proces Kuvendi do të krijojë proces gjithëpërfshirës negociues. Në këtë mënyrë, sigurohet qëndrueshmëria e reformave gjatë ndryshimit potencial të pushtetit.

Rezyme

Kontributi kryesor i Kuvendit në procesin e integritimeve europiane është sigurimi i qëndrueshmërisë së reformave. Deputetët nga njëra anë duhet të sigurojnë dialogun ndërmjet pushtetit, opozitës dhe palëve të tjera të interesuara rreth drejtimeve strategjike dhe zhvillimit që reformat duhet ta sigurojnë për qytetarët. Nga ana tjetër, qëndrueshmëria sigurohet dhe me arritjen e sukseseve të reformave, që duhet të jetë lëndë e mbikëqyrjes së vazhdueshme parlamentare.

Informacion mbi projektin

Bisedime anti-korrupsion në Parlament është projekt i cili synon fuqizimin e rolit mbikëqyrës të deputetëve në fushën e luftës kundër korrupsionit. Projekti është financuar nga Fondacioni Kombëtar për Demokraci nga SHBA-ja.

Informacion mbi IDSCS

IDSCS është think tank - organizatë civile që hulumton zhvillimin e qeverisjes së mirë, shtetin e së drejtës dhe integrimin evropian të Maqedonisë. IDSCS ka për mision ndihmën e angazhimit qytetar në vendimmarrje dhe për të forcuar kulturën pjesëmarrëse politike. Duke zhvilluar vlerat liberale, IDSCS kontribuon në bashkëjetesën midis diversitetit.

Informatat kontaktuese për IDSCS

Adresë: Str. Miroslav Krlezha No.
52/1 /2, 1000 Shkup
Telefoni / Fax: +389 2 3094760
E-Mail: contact@idscs.org.mk

Për autorin

Misha Popoviq është një studiues i vjetër dhe koordinatori programor i Qendrës për Menaxhim më të Mirë pranë IDSCS-së. Anëtar i Këshillit të Platformës së Shoqërive Civile për luftën kundër korrupsionit.

Link

Ky publikim është në dispozicion në:

- <https://idscs.org.mk/mk/portfolio/roli-i-kuvendit-ne-integrimet-europiane-antikorrupsioni/>

Diskutim për politika publike nr. 25/2020

Roli i Kuvendit në integrimet europiane: antikorrupsioni

Autor: Misha Popoviq

-

qershor 2020